



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

**KOMUNA KLINE**

**ZYRA E PROKURIMIT**

01 NR. 351-5384/18

DATE 10.08.2018

**KONTRATA NR.060/2018**

**Komuna Kline**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), qe perfaqesohet nga **Z.Abaz Foniqi** – menaxher i z. Prokurimit në njërën anë; dhe

**TOSI – V " SHPK –nga PEJA** (në vazhdim "Kontraktuesi"), "me numer biznesi **71215598** dhe numer fiskal **601542005** . **ME PRONAR Z. VLOR UKELLA** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

**RENOVIME "**

**LOT 1- RENOVIMI I EMERGJENCES DHE OBJEKTIT TE QKMF NENE TEREZA NE KLINE,**

**Dhe**

**LOT 2- RENOVIMI I ZYRES SE OFIQARISE GLLAREVE**

**me numër identifikues: 634-18-3984-521/634-18-004-DHE 050-521**

**Neni 1 Lënda**

Lënda e kotrates eshte :PUNE - sipas paramanave te dhena ne Oferte

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve eshte:

**34.787.58 € ( Trisdhietekatrmijeshatetegindetetedhjeteshatteeuroe 58/100 euroe )**

( Nga Shendetesia vlera 22.068.95 € dhe nga Administrata 12.718.63 €

2.2. Vlera e kontrates Sipas Planit Dinamik eshte 60 dite pune. .

2.3. Kontrata do te jete kontrate publike per Njesis per PUNE -.

	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER PUNET NE REPARTIN E EMERGENCES NE SHTEPINE E SHENDETIT NE KLINE				
		<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Totali €</b>
<b>A</b>	<b>PUNET PERGADITORE</b>				
A1	Furnizimi dhe montimi I panelave nga pvc-ja te pisura me elemente percjellese per ndarje te perkohshme te hapesires se adoptuar per emergjence, kjo duhet te behet paraprakisht per te krijuar kushte per pune te perkohshme.	m2	63	20.00	1.260.00
A2	Furnizimi transporti dhe montimi I cerades per te krijuar mbulesa te perkohshme te hapesires se adaptuar per pune,perforcimi I saj behet me unaza metali te lidhura dhe te perforcuara ne trajet e betonit per reet hapesires.	m2	60	2.00	120.00
<b>B</b>	<b>PUNET E DEMOLIMIT</b>				
B1	Demolimi I murit ekzistues me trashesi 25cm ne hapesiren e lidhtores,transporti dhe hudhja ne deponi te caktuar,rrafshimi dhe pergaditja e siperfaqes se demoluar per shtresat finale.( 3.3mx3.0m).	m2	10	10.00	100.00
B2	Demolimi I murit ekzistues me trashesi 25cm ne hapesiren e infuzioneve,transporti dhe hudhja ne deponi te caktuar,rrafshimi dhe pergaditja e siperfaqes se demoluar per shtresat finale.( 5.7mx3.0m).	m2	17	10.00	170.00

B3	Demolimi I murit ekzistues me trashesi 25cm ne hapesiren e kontrollit te mjekut,transporti dhe hudhja ne deponi te caktuar,rrafshimi dhe pergaditja e siperfaqes se demoluar per shtresat finale.( 3.3mx3.0m).	m2	10	10.00	100.00
B4	Demolimi I murit ekzistues me trashesi 25cm ne hapesiren e urgjences,transporti dhe hudhja ne deponi te caktuar,rrafshimi dhe pergaditja e siperfaqes se demoluar per shtresat finale.( 3.3mx3.0m).	m2	18	10.00	180.00
B6	Demolimi I hapesires ne murin ekzistues per hapje te dritares per funksionalizimin e sportelit 1m2,dhe demolimi I murit ne hapesiren e infuzioneve ne madhesi te deres 2m2,rrafshimi dhe finalizimi me shtresa finale te suvatimit ne vendin e hapjes.	m2	3	10.00	30.00
	PUNET E DEMONTIMIT DHE MONTIMIT TE RAMAVE -DYERVE NGA PVC. (Duhet ti kushtohet kujdes ruajtjes se materialit gjat demontimit per shkak te perdorimit te serisem te tyre.)				
B7	Demontimi dhe montimi I serisem I ramave ekzistues nga pvc ja ne hapesiren e emergjences (2.5x3.3)x3 dhe 3.5x3.0m,ketu perfshihet edhe pastrimi I tyre si dhe rrafshimi dhe lysterja e vendeve me shtresat finale aty ku kan qen ramat nga pvc-ja.	m2	35.5	5.00	177.50
B8	Demontimi I ramit ekzistues nga pvc ja ne hapesiren e emergjences 3.6x2.5m, dhe deponimi ne vend te caktuar.	m2	9	10.00	90.00

B9	Demontimi dhe montimi I serisem I ramit ekzistues me dyer levizese nga pvc ja ne koridorin e hapesires se emergjences 3x3.30m,te pritja e pacienteve,ketu perfshihet edhe pastrimi I tij,ankerimi si dhe plotesimi me elementet percjellese te tij.	m2	10	10.00	100.00
B10	Demontimi I dyerve me dim.110/210cm, ne hapesiren e lidhtores dhe mjekut,ruajtja dhe sigurimi I tyre nga demtimi per montim ne vend tjeter.	cope	2	5.00	10.00
C	PUNET E MURATIMIT DHE NDERTIMIT TE ANEKSIT TE EMERGENCES				
C1	Furnizimi me blloqe siporeks dhe muratimi i mureve të brendëshem per ndarjen e hapesirave ne emergjence me trashësi d=12cm sipas projektit. 3.38x2m, 4.48x2m, 4.48x2m, 5.7x2m, suvatimi I ketyre mureve me llaq rrjet me kende ,glet sidhe lyerja me polikollor.	m2	40	20.00	800.00
C2	Furnizimi me blloqe siporeks dhe muratimi i murit ne koridorin e dhomave te kujdestarise dhe muri ne hapesiren e sportelit me trashësi d=12cm sipas projektit, suvatimi I ketij muri me llaq rrjet me kende ,glet sidhe lyerja me polikollor.	m2	20	18.00	360.00
C3	Furnizimi dhe veshja e shtyllave ekzistuese me blloqe siporeks ne hapesiren e emergjences me trashësi d=12cm,per mbeshtetjen e ramave te pvc, suvatimi I ketij muri me llaq rrjet me kende ,glet sidhe lyerja me polikollor.	m'	15	15.00	225.00

C4	Furnizimi transporti dhe montimi I trajeve mbajtese ne aneksin e emergjences te profileve metalike terthore dhe gjatesore ne distance 2m me dim.2.5x100x100mm te saldohen dhe perforohen ndermjet veti ,perforcimi I tyre ne traun ekzistues te betonit behet me mbeshtetese dhe ankera ne vrima te hapura me pare, pllaka metalike te perforcuara me bulona.	m'	85	10.00	850.00
C5	Furnizimi transporti dhe montimi I trajeve me profile metalike sekondare 2.5x50x50mm terthore ne aneksin e emergjences per mbeshtetje te llamarines perforcimin e saj ne ane esiperme,si dhe te plafonit knauf ne anen e poshtme,saldimi ose perforcimi me bulona adkuat per mbajtesit primar.	m'	140	10.00	1.400.00
C6	Furnizimi transporti dhe montimi I llamarines se plastifikuar mbi aneksin e emergjences,perforcimi I saj per mbajtesit sekondar,si dhe mbeshtjellja vertikale e konstruksionit.	m2	80	10.00	800.00
C7	Furnizimi transporti dhe montimi I plafonit me pllaka knauf,ne aneksin e emergjences te perfishihen elementet perforcuese kendet bulonat rrjeta si dhe rrafshimi dhe lyezja me glet dhe polikollor.	m2	80	10.00	800.00
E	PUNET E DYERVE DHE DRITAREVE - RAMAVE NGA PVC-JA				
E1	Furnizimi transporti dhe montimi I dritareve nga PVCja ne aneksin e emergjences,330x50cm,me trashesi te profilit 7cm, te cilat montohen mbi ramat e zhvendosur ekzistues.	cope	3	150.00	450.0
E2	Furnizimi transporti dhe montimi I dritareve nga PVCja ne aneksin e emergjences,560x100cm, me trashesi te profilit 7cm, te cilat montohen mbi muret e siporexit.	cope	3	500.00	1.500.00

E3	Furnizimi transporti dhe montimi I dritares nga PVCja ne aneksin e emergjences,340x100cm, me trashesi te profilit 7cm, montohet mbi murin e siporexit.	cope	1	300.00	300.00
E4	Montimi I dycve te demontuara me par nga hapcsira e lidhtores dhe mjekut ne hapcsiren per infuzione dhe ne koridorin e kujdestarise nga pvcja 100x210cm.	cope	2	10.00	20.00
E5	Furnizimi transporti dhe montimi I dycve nga pvcja 100x210 ne hapcsiren e emergjences dhe ne dhomen e re te mjekut, sipas projektit.	cope	2	120.00	240.00
E6	Furnizimi transporti dhe montimi I dritares nga pvcja 100x100cm ne hapcsiren e sportelit e cila permban ne veti edhe dritaren me dim.50x50cm me mekanizem per hapje dhe mbyllje.	cope	1	100.00	100.00
F	PUNET E SUVATIMIT, GLETIMIT DHE LYERJES				
F1	Gerryerja dhe heqja e lyerjes te mureve dhe plafonit ne dhomat e injeksionit infuzioneve te emergjences ekzistuese te hapcsires se kujdestarise lidhtores dhe koridoreve ne ato vende ku eshte e demtuar si dhe largimi I suvatimit ne disa vende ne llogari hyne edhe bartja deri ne deponi te cilen e cakton organi mbikeqyres.Furnizimi transporti dhe lyerja e ketyre siprfaqeve me ngjyre polikollor,ne llogari hyne edhe riparimi me rrjete i vendeve te demtuara plasaritjeve te murit dhe kendeve te shtyllave si dhe rreth dycve dhe dritareve ne pjesen e mbrendshme,nje pjese e kesaj siprfaqe qe duhet te lyhet i takon edhe hapcsirave tjera jashte repartit te emergjences.	m2	1400	1.50	2.100.00
G	PUNET E DYSHEMESE				

G1	Pastrimi dhe gerryerja e dyshemese rrafshimi I vendeve te vrazhda, furnizimi transporti dhe shtruarja e linoleumit me ngjyre te gjelbert ne repartin e emergjences komplet me dhomat percjellese, ne llogari hyn edhe ngjitesi si dhe ngjitja vertikale rreth mureve 7cm.	m2	350	6.00	2.100.00
H	PUNE TE TJERA TE NDRYSHME				
H1	Furnizimi transporti me panela levizes nga sintetika korniza e tyre metalike me prerje rrethore te paisura me rrota qe I mundesojne ndrimin e vendit varsisht nga nevoja qe stafi mjekesore e vlereson, me dimensione 2.0x2.0m	cope	10	6.00	2.100.00
H2	Furnizimi dhe montimi I trupave ndriques ne aneksin e emergjences 40x40cm ose ekuivalent ne qmim perfshihet furnizimi me kabull adekuate dhe kyqja ne rrjetin elektrik, paisja me nderpreresit adekuat si dhe montimi 10 prizave, siguresave automatike, si dhe material I imet lidhes dhe montues i pa specifikuar.	komplet	1	500.00	500.00
H3	Meremetimi I wc-se se kujdestarise.	I	1	200.00	200.00
H4	Furnizimi dhe montimi I keramikes me dimensione sipas pergjedhjes se organit mbikeqyres, ne qmim hyn ngjitesi dhe fugat.	m2	10	10.00	100.00
H5	Furnizimi transporti dhe montimi I radiatoreve ne emergjence, ne qmim perfshihet edhe kyqja ne rjetin e ngrohjes se objektit tubat e furnizimit, valvulat si dhe elementet tjera percjellese te nevojshme.	cope	4	80.00	320.00

H6	<p>Furnizimi transporti ndertimi I nje garazhe ne oborrin e QKMF se nga llamarina e plastifikuar e valezuar me dimensione te bazes 3.0x8.0m, me lartesi ballore 3.0m me pjerresi te llamarines se kulmit nga ana e prapme me lartesi 2.40m ,me konstruksion metalik me prerje terthore 8x5cm per shtylla dhe traje.Shtyllat duhet te ankerohen ne baze te betonit ne vrime te hapura me pare,duhet te perfshihen edhe shtangimet e nevojshme,elementet perforcuese,saldimi i elementeve,gjithashtu garazha duhet te paset me dy dyer metalike 2.0x2.0m.Aplikimi i llamarines eshte per mbeshtjellje te garazhes dhe per kulm. Baza paraprakisht duhet te behet me zhavor te ngjeshur si dhe nje shtrese te betonit me trashesi 7cm me rrjet.</p>	komplet	1	1.000.00	1.000.00
H7	<p>Pune te pa parapara gerryerje, rrafshime, lyerje, meremetime ,intervenime ne pjese dhe vende te nevojshme etj.</p>	komplet	1	100.00	100.00
				<b>GJITHSEJ</b>	<b>18.702.50 =TVSH 3.366.45 22.068.95€</b>



**LOT 2:****PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNEVE NDERTIMORE TE RENOVIMIT  
TE OBJEKTIT TE ZYRES SE VENDIT NE GLLAREVE**

Nr. rendor	Pershkrimi I puneve	njesia	Sasia	Çmimi njesi	Total
A	<b>DEMOLIMI</b>				
1	Demolimi I strehes se demtuar me llampari te kulmit te pjerret,hudhja ne deponi te caktuar qe e cakton organi mbikeqyres.	m2	20.00	1.00	20.00
2	Gerryerja dhe pastrimi I kulmit te rrafshet,duke perfshir edhe ulluket horizontal te kulmit te rrafshet,hudhja ne deponi te caktuar qe e cakton organi mbikeqyres.	m2	30.00	1.00	30.00
3	Demolimi I ramava te dritareve dhe dyerve metalike dhe nga druri,pastrimi dhe gerryerja e rrethit te tyre,hudhja ne deponi te caktuar nga organi mbikeqyres.	m2	30.00	2.00	60.00
4	demolimi I murit te wc dhe hudhja ne deponi e materalit.	m2	4.00	5.00	20.00
5	Gerryerja dhe pastrimi I dyshemese nga laminati dhe linoleumi I vjeteruar dhe hudhja ne deponi.	m2	55.00	2.00	110.00
6	Demolimi dhe heqja e suvatimit ne kthinat e mbrendshme,ne llogari hyne edhe bartja deri ne deponi te cilen e cakton organi mbikeqyres.	m2	165.00	1.00	165.00
B	<b>PUNET E KULMIT</b>				
7	Montimi i strehes te kulmit te pjerret nga llamarina e plastifikuar perforcimi I saj per trajet ekzistues.	m2	20.00	5.00	100.00

8	Furnizimi transporti dhe montimi I kulmit te pjerret me keto shtresa: llamarina e plastifikuar e valezuar, listella, folie, listella, trajet e drurit 8x10cm, ne qmim hyjn te gjitha mjete lidhese dhe elementet thera percjellese te nevojshme.	m2	33.00	19.00	627.00
9	Furnizimi transporti dhe montimi I ulluqeve horizontal dhe vertikal nga llamarina e plastifikuar.	m'	12.00	4.00	48.00
C	DYERT DHE DRITARET				
10	Furnizimi transporti dhe montimi I deres se hyrjes nga Pvc ja, modeli pergjedhet nga organim bikeqyres, ne qmim perfshihen edhe grilat metalike nga ana e jashtme me profile hekuri 2cm ne distanc 12/12cm, si dhe ankerimi ne muri. Dim.e deres 130/260cm.	cope	1.00	350.00	350.00
11	Furnizimi transporti dhe montimi I dyerve te mbrendshme nga Pvc ja.	X	X	X	X
	85/200cm	cope	2.00	130.00	260.00
	145/200cm	cope	1.00	220.00	220.00
	70/200cm	cope	1.00	90.00	90.00
12	Furnizimi transporti dhe montimi I dritareve nga Pvc ja, me xham 4x16x4, ne qmim perfshihen edhe grilat metalike nga ana e jashtme me profile hekuri 2cm ne distanc 12/12cm, si dhe ankerimi ne muri.	X	X	X	X
	160/140cm	cope	3	220.00	660.00
	80/140cm	cope	2	90.00	180.00
	65/65cm	cope	1	50.00	50.00
D	PUNET E MURATIMIT				

13	Furnizimi muratimi dhe suvatimi me llaq I mureve me siporex 12cm pergatitja per shresat finale.	m2	18.5	25.00	462.500
E	<b>PUNET E SUVATIMIT</b>				
14	Furnizimi transporti dhe lyerja e mureve me llaq me baze gipci ne qmim hyn edhe kendet rreth dritareve dhe dyerve, vendosja e shtreses se gletit si dhe lyerja me polikollor ne qmim hyn edhe rregullimi I pjeseve te demtuara.	m2	215	2.00	430.00
F	<b>PUNET E KNAUFIT</b>				
15	Furnizimi transporti dhe montimi I plafonit me pllaka knauf ne trajet ekzistuese te drurit ne qmim hyn elementet perforcuese, rrjeta, llaqi per rrafshim te fugave.	m2	57	10.00	570.00
G	<b>PUNET E DYSHEMESE ,KERAMIKES DHE IZOLIMIT.</b>				
16	Furnizimi dhe shtruarja e shtreses se nivelizimit estrih 5cm, stiropor 2cm, folie, si dhe pergatitja per shtresen finale.	m2	42	5.00	210.00
17	Furnizimi transporti dhe shtruarja e granitit artificial me trashesi 1cm dhe dim. 30x30cm, ne qmim hyn ngjitesi dhe fugat si dhe ngritja 7cm ne vertikale per rreth murit, ne siperfaqe perfshihet edhe shtruarja dhe veshja e shkalleve me granit ato te jashtme dhe te mbrendshme (5m2).	m2	60	12.00	720.00
18	Furnizimi dhe lyerja me izolim te ftoht te wc se ne dysheme dhe 40cm ne muri.	m2	7	2.00	14.00

19	Furnizimi transporti dhe montimi i keramikës për banjo në mure, forma dhe ngjyra përzgjedhet nga organimbikeqyres, në qmim hyn edhe ngjitesia dhe fugat, me lartësi 1.6m në muri.	m2	14	11.00	154.00
H	<b>PUNET E FASADES</b>				
20	Pastrimi dhe gërryerja në vendet e nevojshme të fasadës ekzistuese, furnizimi transporti dhe montimi i fasadës me këto shtresa: ngjites, stiropor N4 t-10cm, ngjites, rrjete plastike adekuate, ngjites, fasade 2.5mm.	m2	220	11.00	2.420.00
21	Furnizimi transporti dhe lyerja me kolir plastik të çokës.	m2	24	8.00	192.00
I	<b>PUNET E ELEKTRIKES</b>				
22	Furnizimi transporti dhe montimi i elementeve të nevojshme të instalimit elektrik për 55m <sup>2</sup> : trupa ndriqes, ndërpresa, prizë, siguresa, kablo furnizuese dhe material tjetër të nevojshëm. - Sqarim rrjeti gjendet në objekt. Në qmim hyn edhe montimi i rrufepritesit dhe shiritit të tokëzimit.	komplet	1	700.00	700.00
J	<b>PUNE TE UJESJELLESIT</b>				
23	Hapja dhe mbyllja e kanalit nga dheu, shtrirja e gypit furnizues për ujë në distancë 250m si dhe kyqja në objekt.	m'	250	2.00	500.00
24	Demontimi dhe montimi i guaces ekzistuese, furnizimi transporti dhe montimi i lavamanit, si dhe materialit të imet percjelles.	komplet	1	60.00	60.00
K	<b>PUNET E OBORRIT</b>				

25	Furnizimi transporti shtruarja dhe ngjeshja e kubezave nga betoni me trashesi 8cm,si dhe skajoret e betonit,paraprakisht rregullimi i terenit shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit me trashesi 20cm, si dhe mbushja e fugave ndermjet kubeave.	m2	35	10.00	350.00
26	Demolimi dhe largimii i rrethojes ekistuese,si dhe deponimi ne vend te caktuar.	m'	18	2.00	36.00
27	Furnizimi transporti dhe montimi i rrethojes metalike me lartesi 1.5m,me profile 2cm, te vendosura ne distance 12cm,te perforcuara ne beton ne vrima te hapura me pare me shtylla metalike 5/7cm ne distance 2m, gjithashtu duhet te vendosen dy dyer 1m,dhe 2m gjeresi te dyerve,te paisure medorez dhe qeles, ne qmim hyn edhe lyerja me ngjyre antikorrozive.	m'	48	15.00	720.00
L	TE TJERA				
28	Furnizimi dhe montimi i pllakes nga plastika0.6x1m,me mbishkrimin e institucionit.	cope	1	250.00	250.00
					<b>10.778.50€</b>
					<b>Tvsh</b>
					<b>1.940.13</b>
					<b>gjithesej: 12.718.63€</b>

2.4. Garancioni i Kontrates ne vlere 3.478.76 € me validitet 60+30= 90 dite kalendarik.

2.4. **Plani per implemetim programi do te jete Sipas Porosive nga Menaxheri i Kontrates**

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.-sipas situacioneve dhe perfundimit te sherbimeve sipas planit dinamik , me raport nga menaxheri i projektit, raport pranimi dhe raportin detal te menaxhmit te kontrates - pas perfundimit te sherbimeve

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**4.5. Per menaxhim te kontrates bazuar ne nenin 81 te LPP 04/L-42 emerohet me vendim te ZKA –kryetarit nga Drejtoria e SHENDETESISE DHE ADMINISTRATES me vendim.**

Për Autoritetin Kontraktues  
Komuna Kline

Për Kontraktuesin

TOSI V- SHPK – PEJE

<b>Emri:</b>	<b>Abaz Foniqi</b>		VLOR UKELLA	
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit		I Autorizuar	
<b>Nënshkrimi:</b>				
<b>Data:</b>	10.08.2018		10.08.2018	
<b>Vula:</b>				

## **PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

- 1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 “**Ofruesi i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve sigruarve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur sigruarët e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerisë.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njez lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejojë Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informojë Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata lyp në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisht është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:



(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbysur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë të pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

#### **Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 13 Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### **Neni 14 Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shumat nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbripte që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### **Neni 17 Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

#### **Neni 18 Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i tyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

## 1. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Kline .
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është : <i>Nga DKA me vendim te ZKA</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është <b>10 % NGA VLERA E KONTRATES PER PERIUDHEN 60+30=90 dite</b> <i>Perkatesisht vlera 3.478.76 €.</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % nga Punekryesi b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % nga punekryesi c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve Pergjegjesi e punekryesit d) Përgjegjësia profesionale e O.E. e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pergjegjesi e o.e.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Punet –Shërbimet duhet te jene ne cilesi dhe saktesi simbas specifikacionit te produkteve te perdorura dhe cilesis se punimeve conform ofertes . Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <b>aty per aty</b> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është <i>gjate tere afatit te Implementimit te projektit:</i> <b>12 muaj pas pranimit te puneve</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në

gjqësore	<p><b>Kosovë.</b></p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të në pajtim me <i>specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)</i>].</p>
----------	--

## SIGURIA E TENDERIT

Për: **Komuna e Klinës**  
(në vazhdim "autoriteti kontraktues").

Ne emër të: "**TOSI-V**" SH.P.K. , **FEHMI AGANI NR.24 Peje**  
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: **RENOVIME, LOT 2- RENOVIMI I ZYRES SE OFIQARISE NE GLLAREVE,**  
NR.I PROKURIMIT:634-18-3984-5-2-1

### Garancion me kërkesë të parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **Nje mije 1,000.00 €** zotohemi të paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderuesi i ka dhënë informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
  - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
  - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
  - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,000.00 €** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri është e vlefshme **90 ditë** prej **26.06.2018** deri më **24.09.2018**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

 **SIGKOS**  
KOMPANIA E SIGURIMEVE  
INSURANCE COMPANY

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.

Rr.Sylejman Vokshi, Pallati i kuq L-B nr.1, Prishtinë

Data  
26.06.2018

## SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Klinës**  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **"TOSI-V" SH.P.K. , FEHMI AGANI NR.24 Peje**  
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: LOT 1-RENOVIMI I EMERGJENCES DHE OBJEKTIT TE QKMF NENE TEREZA, LOT 2:RENOVIMI I ZYRES SE OFIQRARISE NE GLLAREVE,  
NR.I PROKURIMIT:634/18/3984/5/2/1

### Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Tre mije e Kater qinde e Shtatedhjete e Tete e Tete qinde 3,478.80 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **3,478.80 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **90 ditë** prej **10.08.2018** deri më **08.11.2018**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në mënyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.



**SIGKOS**  
KOMPANIA E SIGURIMEVE  
INSURANCE COMPANY

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.  
Rr.Sylejman Vokshi, Pallati i kuq L-B nr.1, Prishtinë

Data  
10.08.2018